



*Gëzuar Krishtlindjet dhe
Urimet më të mira për Vitin e Ri!*

Takim i Znj. Enkeleda Shehi, Kryetare e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, me përfaqësues të tregjeve të mbikëqyrura nga AMF, për projektet e vitit 2013

Duke përmendur disa nga aktivitetet kryesore gjatë vitit 2012 në tregjet financiare që Autoriteti mbikëqyr, Kryetarja e Autoritetit i cilësoi ato si zhvillime të rëndësishme, por edhe me sfida të cilat nuk kanë munguar.

Vijon në faqen 2

VËSHTRIM MBI TREGJET

Tregu i sigurimeve për periudhën janar-nëntor 2012

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimeve për periudhën janar-nëntor 2012 arritën shifrën 8,033,220 mijë lekë.

Vijon në faqen 3

EDUKIMI I KONSUMATORIT

Rëndësia e edukimit të investitorëve dhe sfidat reale të sotme

Fjala e mbajtur nga David Wright, Sekretar i Përgjithshëm i IOSCO-s, në Konferencën për Edukimin e Investitorëve IOSCO/IFIE Seul, Kore, 21 maj 2012

Vijon në faqen 6

ZHVILLIME TË TJERA

Zhvillohet takimi i katërt rajonal i rregullatorëve të tregjeve të sigurimeve të vendeve të Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore (5-6 dhjetor, Vjenë, Austri)

Vijon në faqen 9

TË REJA NGA RAJONI

Nëntëmujori i vitit 2012

Kosovë

Vijon në faqen 10

Moldavi

Vijon në faqen 10

Ukrainë

Vijon në faqen 11

Kroaci

Vijon në faqen 11

Estoni

Vijon në faqen 11

Takim i Znj. Enkeleda Shehi, Kryetare e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, me përfaqësues të tregjeve të mbikëqyrura nga AMF, për projektet e vitit 2013

Gjatë vitit 2013 për tregun e sigurimeve si tregu më aktiv nga segmentet e mbikëqyrura nga AMF në vëmendjen tonë, veçoi Znj. Shehi, do të jenë adresimi i një sërë çështjesh që lidhen me sigurimin e detyrueshëm motorik, duke filluar që nga tarifimi me bazë riskun e deri tek amendimi i ligjit për të zgjidhur një sërë problematikash me të cilat përballet ky treg deri tek mbikëqyrja me fokus riskun.

Kryetarja e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Znj. Enkeleda Shehi zhvilloi më datë 20 dhjetor një takim përmbyllës me përfaqësues të tregjeve të mbikëqyrura nga AMF, për të diskutuar mbi probleme të ndryshme me interes të përbashkët, realizimet e vitit 2012, zhvillimet dhe sfidat për vitin që vjen.

Duke përmendur disa nga aktivitetet kryesore gjatë vitit 2012 në tregjet financiare që Autoriteti mbikëqyr, Kryetarja e Autoritetit i cilësoi ato si zhvillime të rëndësishme, por edhe me sfida, të cilat nuk kanë munguar. Tregu financiar e ka zhvilluar aktivitetin e tij në një situatë të përgjithshme makroekonomike disi më pak të favorshme dhe krahas një tregu bankar që ka kufizuar ndjeshëm kreditimin. Viti 2012 ka qenë një vit relativisht i vështirë edhe për tregun e sigurimeve si në këndvështrimin e turrjes së të ardhurave, ashtu edhe të një sërë problematikave si liberalizimi i MTPL, çështjet me fondin e kompensimit e deri te vlerësuesit e dëmeve.

Gjatë vitit 2013, për tregun e sigurimeve, si tregu më aktiv nga segmentet e mbikëqyrura nga AMF në vëmendjen tonë, veçoi Znj. Shehi, do të jenë adresimi i një sërë çështjesh që lidhen me sigurimin e detyrueshëm motorik, duke filluar që nga tarifimi me bazë risku, amendimi i ligjit për të zgjidhur një sërë problematikash me të cilat përballet ky treg dhe deri tek mbikëqyrja me fokus riskun. AMF po mbështetet në këtë drejtim nga projekti i Bankës Botërore, i cili është drejt përfundimit.

Kryetarja e Autoritetit e vuri theksin tek vëmendjen dhe energjitë e nevojshme që AMF do t'i kushtojë tregjeve të tjera nën mbikëqyrje. Kështu, viti 2013 fillon menjëherë me një projekt të rëndësishëm në tregun e pensioneve vullnetare private, mbështetur nga BB, me qëllim unifikimin e praktikave me ato të BE. Po kështu AMF do të vijojë të mbështesë lehtësirat fiskale të nevojshme për zhvillimin e këtij tregu, duke lobuar me institucionet përgjegjëse.

Për tregun e Letrave me Vlerë, Kryetarja e AMF-së, Znj. Shehi nënvizoi se mbetet ende një treg i pazhvilluar. Por kjo nuk mund të thuhet për fondet e investimit, dinamika e lartë e zhvillimit të tyre ka tejkaluar çdo pritshmëri dhe ka bërë që AMF t'i kushtojë këtij segmenti një hapësirë të rëndësishme për vitin 2013. Kështu, në bashkëpunim me Korpusin Vullnetar të Shërbimeve Financiare, FSVC, janë programuar 3 projekte të rëndësishme gjatë vitit 2013, duke filluar që nga strategjia e zhvillimit të tregut të Letrave me Vlerë në tërësi e deri tek hartimi i rregullave të nevojshme për zhvillimin e tregut dhe operatorëve të tij.

AMF do të prezantojë ndryshimet ligjore për të konsoliduar pavarësinë e saj si rregullator me qëllim rritjen e cilësisë mbikëqyrëse.

Në përfundim të takimit Kryetarja e Autoritetit, Znj. Enkeleda Shehi, prezantoi një projekt afatgjatë mjaft të rëndësishëm, i cili është ende në fazën e formësimit të plotë në bashkëpunim edhe me FSVK-në. Ky projekt, theksoi Znj. Shehi, lidhet me ngritjen e qendrës së trajnimit dhe të kërkimit për tregun financiar, i cili do të mbështesë rritjen e cilësisë së ekspertëve të tregut financiar. Ngritja e kësaj qendre është një domosdoshmëri e kohës dhe përputhet me synimet e ligjeve të fushës si dhe të projektligjit të sigurimeve për aftësimin e vazhdueshëm të profesioneve të caktuara. Për këtë projekt të AMF-së, Kryetarja e Autoritetit, kërkoi edhe mbështetje nga tregu si një projekt që i shërben vetë atij.

Përfaqësuesit e shoqërive të sigurimit shprehën rezultatet e arritura gjatë vitit 2012 në punën e tyre dhe siguruan për vazhdimësinë e bashkëpunimit edhe me tej me Autoritetin për realizimin e projekteve të përbashkëta.


VËSHTRIM MBI TREGJET

Tregu i sigurimeve për periudhën janar-nëntor 2012

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimeve për periudhën janar-nëntor 2012 arritën shifrën 8,033,220 mijë lekë, përkundrajt 7,676,310 mijë lekë të realizuara në janar-nëntor 2011 ose 4.65% më shumë se e njëjta periudhë e vitit të kaluar. Primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zunë 49.48% dhe ato të sigurimit të detyrueshëm 50.52% të tregut. Përsa i takon tregut, në veçanti, kemi një rënie në masën 17.52% të sigurimeve të Jetës dhe një rritje prej 7.66% të sigurimeve të Jo-Jetës. Nga të ardhurat gjithsej të tregut 90.05% e primeve u gjenerua nga sigurimet e Jo-Jetës, 9.65% nga veprimtaria e Jetës dhe 0.30% nga veprimtaria e risigurimit.

Në janar-nëntor 2012 u nënshkruan rreth 1,097,726 kontrata sigurimi, ose 7.56% më pak se në janar-nëntor 2011.

Struktura e tregut të sigurimeve, për janar-nëntor 2012




Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimeve për periudhën janar-nëntor 2012 arritën shifrën 8,033,220 mijë lekë.

Volumi i primit të shkruar bruto, për periudhën janar-nëntor 2011, 2012

Lloji i sigurimit	Vlera (në mijë Lekë)	
	janar-tetor 2011	2012
A) Sigurim i Jetës	939,735	775,086
B) Sigurim i Jo-Jetës	6,719,458	7,234,265
<i>Nga këto:</i>		
a) Sigurimi Detyrueshëm	3,461,150	4,058,088
b) Sigurimi Vullnetar (Jo-Jetë)	3,258,308	3,176,177
C) Risigurimi	17,117	23,869
TOTAL	7,676,310	8,033,220

Volumi i primit të shkruar bruto, për janar-nëntor 2012 (Jeta dhe Jo-Jeta)



Sigurimet e detyrueshme motorike

Në janar-nëntor 2012, sigurimet e detyrueshme motorike sollën 4,058,088 mijë lekë të të ardhurave nga primet e shkruara bruto të tregut të sigurimeve.

Primet e shkruara bruto të sigurimit TPL e brendshme për janar-nëntor 2012, arritën 2,969,771 mijë lekë, ose 45.82% më shumë se janar-nëntor 2011.

Në janar-nëntor 2012, primet e shkruara bruto të Kartonit Jeshil ishin 615,291 mijë lekë, ose rreth 41.29% më pak se në janar-nëntor 2011. Kjo ulje e primit shkruar bruto Karton Jeshil lidhet me liberalizimin tregut të sigurimit të detyrueshëm në gusht të vitit 2011.

Primet e kontratës së sigurimit kufitar gjatë janar-nëntor 2012 arritën në 473,026 mijë lekë, apo 25.59% më shumë se në janar-nëntor 2011.

Sigurimet vullnetare

Për janar-nëntor 2012, të ardhurat nga sigurimet vullnetare arritën në 3,975,132 mijë lekë, ose 5.69% më pak se të ardhurat e janar-nëntor 2011.

Në sigurimet vullnetare të Jo-Jetës, me të ardhura 3,176,177 mijë lekë, vendin e parë e zunë sigurimet nga zjarri dhe dëme të tjera në pronë me 44.85% të pasuara nga sigurimet e aksidenteve dhe shëndetit me 17.98%, dhe nga sigurimi Kasko me 15.68%. Peshë më të ulët patën sigurimi i përgjegjësive të përgjithshme civile, sigurimet e garancisë.

Të ardhurat nga sigurimet e aksidenteve dhe shëndetit, në janar-nëntor 2012, arritën në 571,003 mijë lekë, 29.85% më pak se në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Peshën më të madhe e mbajtën sigurimet e klasës 1, sigurimi i aksidenteve me 62.16% të të ardhurave të këtij grupi.


Primet në sigurimet e jetës në janar-nëntor 2012 arritën në 775,086 mijë lekë, ose 17.52% më pak se në janar-nëntor 2011.

Ndarja e tregut midis shoqërive të sigurimit


Tregu shqiptar i sigurimeve të Jo-Jetës ndahet ndërmjet shoqërive të sigurimit: SIGAL UNIQA Group Austria, SIGMA Vienna Insurance Group, INSIG, ATLANTIK, INTERALBANIAN, ALBSIG, INTERSIG Vienna Insurance Group EUROSIG dhe ANSIG.

SIGAL UNIQA Group Austria udhëhoqi tregun me 31.05% të primeve.

Pjesëmarrja e shoqërive në tregun e sigurimit, për janar-nëntor 2012 (Jo-Jeta)



Pjesëmarrja e shoqërive në tregun e sigurimit, për janar-nëntor 2012 (Jeta)



Aktivitetin e sigurimit të Jetës e ushtruan kompanitë SIGAL-LIFE UNIQA Group Austria, INSIG dhe SICRED. SIGAL-LIFE UNIQA Group Austria udhëhoqi tregun me 51.58% të primeve.

Dëmet

Totali i dëmeve të paguara bruto nga shoqëritë e sigurimeve në janar-nëntor 2012 kapi vlerën 2,455,388 mijë lekë, ose 28.76% më shumë se në janar-nëntor 2011. Për vetë strukturën e tregut të paraqitur më sipër, pjesa më e madhe e dëmeve të paguara u përket sigurimit motorik me 1,834,525 mijë lekë, apo 74.71% të totalit.

Totali i dëmeve të paguara bruto nga shoqëritë e sigurimeve në janar-nëntor 2012 kapi vlerën 2,455,388 mijë lekë, ose 28.76% më shumë se në janar-nëntor 2011.

EDUKIMI I KONSUMATORIT

Rëndësia e edukimit të investitorëve dhe sfidat reale të sotme

*Fjala e mbajtur nga David Wright, Sekretar i Përgjithshëm i IOSCO-s, në Konferencën për Edukimin e Investitorëve IOSCO/IFIE
Seul, Kore 21 maj 2012*

(Marrë me shkurtime)

Tregjet financiare mbetën shumë të paqëndrueshëm në të gjithë botën, duke përfshirë efektet që u ndjenë edhe në Kore. Kriza në Eurozonë, përhapja e borxhit, rritja e ulët ekonomike në vendet e botës perëndimore, papunësia e lartë janë shqetësuese. Nuk ka zgjidhje për këtë krizë të thellë financiare, pa bashkëpunimin e fortë ndërkombëtar, jo vetëm fjalët e bukura diplomatike, por edhe vendime, veprime që do të zbatohen bashkërisht. Kjo për shembull, do të jetë mënyrë efektive në zgjidhjen e dështimeve të institucioneve financiare ndërkufitare pa shkaktuar panik dhe pa rënduar taksapaguesit. Ndërsa tregjet financiare botërore, në mënyrë të pashmangshme zgjerohen me thellimin e lidhjeve të tregtisë globale dhe lidhjeve elektronike dhe komerciale, ne duhet të sigurohemi që sistemi financiar është i sigurt, i qëndrueshëm dhe funksional për ekonominë e jo që ekonomia të punojë për financat.

Me pak fjalë, ky është mandati i G20 dhe FSB (Bordi i Stabilitetit Financiar). Kjo do të thotë përcaktim i mirë i rregullave, zbatim i mbikëqyrjes efektive dhe kuptim i saktë i flukseve të kapitalit dhe problematikave të tregut. Fatkeqësisht asnjë nga këto kushte esenciale nuk u zbatua në tregjet më të mëdha në botë që çoi deri në këtë krizë.

Tregjet financiare janë të përbërë nga kërkesa dhe oferta, shitja me pakicë, me shumicë dhe infrastruktura. Në këtë matricë, pala e shitjes me pakicë është me më pak e njohur, më pak e përgatitura dhe shpesh shumë e ndikueshme nga fuqia e ofertuesve, një ekuacion ky që është përkeqësuar nga asimetritë e informacionit në favor të ofruesve të shërbimeve financiare. Dhe më tej akoma, duke pasur parasysh këto disekuilibra, duke pasur parasysh se popullsia globale është duke shkuar drejt plakjes dhe se vetë ata do të duhet të marrin më shumë përgjegjësi për pensionet e tyre të ardhshme, etj., është sinqerisht tepër e habitshme, se si qeveritë dhe rregullatorët kudo në botë nuk i japin popullsisë në përgjithësi, mjetet për ti marrë këto përgjegjësi, pra aftësinë për të zgjedhur produktet financiare për të cilat ata kanë nevojë nga dhjetëra mijëra në oferta që ka në tregje.

Përgjithësisht, ofruesit e shërbimeve financiare përballen me sanksione të lehta nëse ata shesin keq produktet, bëjnë pak për të mbrojtur konsumatorët apo kryejnë veprime të tjera si mbikëqyrje e parregullt, pa transparencë, drejtimi i biznesit dhe kriteret e përshtatshmërisë. Shkurt, duket sikur i kushtohet kujdes vetëm njërit krah.

Më lejoni të theksoj atë që është e dukshme (ose ndoshta jo aq e dukshme): Edukimi i investitorëve është me të vërtetë i rëndësishëm, në fakt jetik, jo për një minutë kalimtare në histori, por për gjatë gjithë kohës. Investitorët kanë nevojë për edukim e tani më shumë se kurrë për të thyer asimetritë e informacionit, që të jenë në gjendje të orjentojnë me ndryshimet e shpejta

Ndërsa tregjet financiare botërore, në mënyrë të pashmangshme zgjerohen me thellimin e lidhjeve të tregtisë globale dhe lidhjeve elektronike dhe komerciale, ne duhet të sigurohemi që sistemi financiar është i sigurt, i qëndrueshëm dhe funksional për ekonominë e jo që ekonomia të punojë për financat.

në treg dhe për të ekuilibruar më mirë dallimet e mëdha në fuqinë lobuese mes konsumatorëve nga njëra anë, të shpërndarë dhe të fragmentarizuar, dhe industrisë financiare nga ana tjetër, që është në kulmin e shpenzimeve lobuese në shkallë globale.

IOSCO dhe unë e mbështesim plotësisht dhe njohin rëndësinë e edukimit të investitorëve. Unë kam besuar gjithmonë se edukimi financiar duhet të jetë pjesë e kurrikulave bazë në shkolla nga kopshti deri në fund të arsimit të mesëm. Unë jam i kënaqur të vërej se INFE dhe OECD janë dakord.

Duke folur për edukimin e investitorëve, më lejoni të fokusohem në dy pika kritike që shpresoj se ju mund ti zhvillonit më tej në këtë konferencë:

- Si e përcaktoni ju suksesin kur është fjala për edukimin e investitorëve?
- Ku janë të dhënat statistikore që ka qenë vlerësuar me rigorozitet?
 - Çfarë është për t'u matur? (pikët në një testim, paratë e fituara në treg, në se humbasim ose jo para në treg, etj);
 - Si duhet të matet? (Vetë-raportim, sa para janë fituar, rezultatet e larta në një test, etj);
 - A po marrin njerëzit vendime financiare racionale, apo janë të shtyrë nga pasioni?;
 - A po marrin njerëzit vendime më të mira, pasi ata kanë ndjekur kurse të edukimit financiar, duke qenë kështu financiarisht "të arsimuar"?

Çelësi është që të përdoren procedura me mostra të përzgjedhura në mënyrë rastësore që vijnë nga statistikat. Këto sigurojnë se rezultatet e anketimeve të dala nga mostra janë kështu përfaqësuese statistikore të popullsisë. Sondazhet, që nuk ndjekin këto procedura, mund të prodhojnë rezultate që çojnë në studime të gabuara të tregut, apo vendime të politikës.

Çdo i ashtuquajtur "Hulumtim" në të cilin asnjë përpjekje nuk është bërë për të zgjedhur rastësisht të anketuarit, të tilla si "call-in të lexuesve" apo "sondazhe të shikuesve" ka të ngjarë të prodhojë rezultate që në asnjë mënyrë nuk pasqyrojnë mendimin e përgjithshëm publik edhe në qoftë se mijëra individë të marrin pjesë në të.

Më lejoni të citoj një pasazh interesant nga puna e Profesor Willis Lauren, shkruar në vitin 2008 në "IOWA LAW REVIEW", si më poshtë:

"Modeli dominues i rregullimit në Shtetet e Bashkuara (dhe për këtë çështje në shumicën e vendeve) për kredinë konsumatore, sigurimet, dhe produktet e investimeve është shpalosje e një zgjedhje imagjinare. Ndërsa këto produkte janë bërë më komplekse, paaftësia e konsumatorëve për ti kuptuar ato është bërë gjithnjë e më e dukshme dhe pasojat e kësaj paaftësie edhe më të vështira. Në përgjigje të saj, politikëbërësit kanë përqaftuar edukimin financiar si një rrjedhojë e nevojshme.

Ky edukim besohet gjerësisht t'i bëjë konsumatorët lojtarë "përgjegjës" dhe "të fuqizuar" të tregut, të motivuar dhe kompetentë

Unë kam besuar gjithmonë se edukimi financiar duhet të jetë pjesë e kurrikulave bazë në shkolla nga kopshti deri në fund të arsimit të mesëm.

Njohuritë financiare nuk janë elementi i vetëm për të marrë vendime të mira financiare. Sanksionet e forta, mbikëqyrje efektive dhe rregullimi i produktit janë kërkesa thelbësore.

për të marrë vendime financiare që rrisin mirëqenien e tyre. Vizioni i krijuar është ai i konsumatorëve të arsimuar që merren vetë me trajtimin kredive të tyre, të sigurimeve, si dhe çështjet e planifikimit të daljes në pension duke lundruar me besim në një treg të ndershëm dhe të pakufizuar.

Edhe pse ky vizion është joshës, duke premtuar edhe një treg të lirë dhe mirëqenie në rritje të konsumit, besimi në efektivitetin e edukimit financiar nuk ka gjetur mbështetje empirike. Për më tepër, besimi është i papranueshëm, nga shpejtësia e ndryshimit në tregun financiar, hendekun midis aftësive aktuale të konsumatorëve dhe atyre të nevojshme për të kuptuar produktet e sotme financiare komplekse jo të standardizuara, paragjykimet në vendimmarrje financiare.

Duke përkrahur idenë se ky besim mund të jetë i pafajshëm, nga ana tjetër ai nuk është tërësisht i padëmshëm; krijimi i njohurive financiare paraqet kosto që zvogëlojnë shumë përfitimet. Për disa konsumatorë, edukimi financiar rrit besimin, pa përmirësuar aftësinë, duke çuar në vendim e të këqija.

Kur konsumatorët e gjejnë veten në ngushticat financiare, modeli i rregullimit përmes edukimit i fajëson ata vetë për gjendjen e tyre, për zgjedhjet e gabuara në treg. Konsumatorët në përgjithësi nuk janë mjekët e vetvetes as edhe avokatët e vetvetes. Për të njëjtat arsye, të ndarjes efikase të punës, në përgjithësi nuk duhet të shërbejnë si ekspertë vetjakë të financave të tyre. Kërkesa për edukim efektiv financiar duhet të zëvendësohet nga kërkimet për politika më të favorshme që japin rezultate më të mira të konsumatorët financiare.”

Ja si duhet të funksionojë edukimi i investitorëve:

Edukim Financiar → Njohuri Financiare → Vendime dhe Qëndrime të Mira Financiare

Më poshtë do të lexoni disa nga deklaratat provokuese për debat:

- 1. Edukimi i Investitorëve është një ndërmarrje e pamundur duke pasur parasysh kompleksitetin e produkteve financiare të sotme.** Konsumatori, si masë, kurrë nuk do të jetë në gjendje të arrijë plotësisht të përballet me tregun që ndryshon me shpejtësi. Dhënia e informacioneve shpjeguese dhe transparenca janë të pamjaftueshme si një instrument i politikës. *Caveat Emptor* e njohur si “*Le të jetë blerësi i informuar*” nuk është më dhe shitjet e gabuara më të fundme e dëshmojnë atë. Vetëm rregullimi shumë i rreptë i produkteve, sjellja e korrekte ndaj rregullave të biznesit dhe sanksionet parandaluese ndaj shitjeve të këqija kanë shanse për të funksionuar.
- 2. Njohuritë financiare nuk janë elementi i vetëm për të marrë vendime të mira financiare.** Sanksionet e forta, mbikëqyrje efektive dhe rregullimi i produktit janë kërkesa thelbësore.
- 3. Shumica e programeve të edukimit të investitorëve janë joefikase.** Në përgjithësi ata janë shumë të vogla dhe të pafinancuara e zakonisht kanë mungesë të qëndrueshmërisë.

4. Për disa, kurset e edukimit për financat personale çojnë në rritjen e besimit, pa përmirësim të aftësisë dhe potencialisht çojnë në vendimet e këqija. Hulumtimet tregojnë se vetëm programet e përshtatura individualisht në grupe të vogla dhe afatgjata mund të jenë efektive.
5. Rregullimi sipas modelit të arsimit mund të përfundojnë duke fajësuar vetë investitorët për gjendjen e tyre, për vendimet që ata marrin. Ky rregullim sipas modelit të arsimit të investitorëve nuk duhet t'i çlirojë institucionet rregullatore nga detyrat e tyre. Edukimi i investitorëve është një plotësues, ai nuk është zëvendësues i rregullimit bazë.
6. Testimet për edukimin e investitorëve duhet të shtrihen edhe për investitorët profesionale dhe palët e drejtpërdrejta. Ata që dëshirojnë të marrin rolet e lidërshiptit në firmat e mëdha sistematike duhet të provojnë pranë rregullatorëve që ata janë kompetentë, profesionistë dhe me njohuri. Me pak fjalë, se ata janë të aftë për synimin që duhet arritur. Për fat të keq kjo krizë ka treguar se shumë prej tyre nuk ishin.

ZHVILLIME TË TJERA

Zhvillohet takimi i katërt rajonal i rregullatorëve të tregjeve të sigurimeve të vendeve të Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore

Në datat 5-6 dhjetor 2012 në Vjenë, Austri u zhvillua takimi rajonal i rregullatorëve të tregjeve të sigurimeve të Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore. Takimi u organizua nga Autoriteti Austriak i Tregut Financiar, FMA në bashkëpunim me Autoritetin Hungarez të Mbikëqyrjes Financiare, HFSA. Ky është takimi i katërt në kuadër të iniciativës CESEE, për rritjen e bashkëpunimit ndërmjet mbikëqyrësve të sigurimeve nga vendet e Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore. Kjo iniciative është prezantuar fillimisht në prill të vitit 2011 me synim forcimin e bashkëpunimit rajonal dhe ndërtimin e një forumi diskutimi me fokus në problematikat aktuale të vendeve të rajonit.

Diskutimet kryesore në këtë takim u përqendruan në drejtim të forcimit të strukturave të mbikëqyrjes, shkëmbimit të përvojave rreth mekanizmave alternative të zgjidhjes së kontestimeve në sigurime, produkteve të sigurimit të Jetës parë në kushtet aktuale ekonomike, si edhe në rolin e bankave si ndërmjetës sigurimesh.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare u përfaqësua në këtë takim nga Znj. Enkeleda Shehi, Kryetare e Autoritetit, Znj. Teuta Baleta, Këshilltare pranë Kryetares dhe Z. Rinald Guri, Drejtor i Departamentit të TI, Kërkimit dhe Statistikës.

Znj. Teuta Baleta drejtoi seancën e parë, me temë Struktura Mbikëqyrëse Efektive. Seanca kishte në qendër të saj diskutimin për rishikimin e

Një ndër çështjet që tërhoqi më shumë diskutime ishte mbikëqyrja e korporatave.

strukturave mbikëqyrëse rregullatore në funksion të promovimit të stabilitetit financiar, kalimin drejt mbikëqyrjes me bazë risku, përshtatjen e këtyre strukturave me parimet bazë të sigurimeve, etj.

Në këtë takim, morën pjesë autoritetet homologe të vendeve si Austria, Bosnje-Hercegovina, Kroacia, Hungaria, Maqedonia, Mali i Zi, Moldavia, Polonia, Republika Serbe e Bosnjes, Serbia, Sllovenia dhe Sllovakia.

TË REJA NGA RAJONI

Të dhëna për nëntëmujorin e parë të vitit 2012

Kosovë

Primi i shkruar bruto i industrive të sigurimit në Kosovë, për nëntë muajt e parë të vitit 2012 arriti vlerën 63.34 bilion Euro, duke pësuar një ulje me 7.86% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2011. Ndërkohë totali i dëmeve të paguara arriti vlerën prej 21.6 milion Euro ose 9.5% më shumë duke krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, sipas të dhënave të raportuara nga Banka Qendrore e Kosovës (CBK). Këto vlera janë gjeneruar nga 13 sigurues të cilët kanë shitur rreth 578 mijë polica, gjatë periudhës së analizuar.

Sipas statistikave të Bankës Qendrore të Kosovës, policat e MTPL-së zunë rreth 54% të tregut në total, të barabartë me 34.1 milion Euro, ose 212 mijë polica. Klasa e dytë më e rëndësishme është Sigurimi Kufitar. Në këtë rast, siguruesit kosovarë kanë kontribuar në rritjen e tregut me 11.7 milion Euro, duke paraqitur një rritje prej 52% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Në lidhje me numrin e policave, siguruesit lokalë shitën rreth 272 mijë polica kufitarë, ose 95 mijë më shumë në krahasim me janar-shtator e vitit 2011.

Moldavi

Bazuar në të dhënat paraprake të Komisionit Kombëtar të Tregut Financiar, gjatë nëntëmujorit të parë të vitit 2012, volumi total i primeve të shkruara bruto, në tregun e sigurimeve të Moldavisë, arriti vlerën 785.5 MDL, monedha vendase, ose rreth 50.9 milion Euro, duke shënuar një rritje prej 5.3% krahasuar me periudhën janar-shtator 2011.

Në të njëjtën kohë, për këtë periudhë, siguruesit moldavë kanë paguar rreth 267.7 milion MLD ose rreth 17.3 milion Euro.

Sigurimi i Jo-Jetës ka gjeneruar 94% të totalit të tregut 738.5 milion MDL, ku pjesën më të madhe e zënë sigurimet motorike: TPL 22.2%, Kartoni Jeshil 20.4% dhe Kasko 17.3%, ndërkohë sigurimi i pronës dhe shëndetit përbënin vetëm 13.2% dhe 4.4%.

Primi i Shkruar
Bruto i industrive të
sigurimit në Kosovë,
për nëntë muajt
e parë të vitit 2012
arritën vlerën 63.34
bilion Euro, duke
pësuar një ulje
me 7.86% krahasuar
me të njëjtën
periudhë të vitit
2011.

Ukrainë

Gjatë muajit nëntor, Komisioni Kombëtar i Tregjeve Financiare në Ukrainë diskutoi një projektligj për organizimin e Fondit të Garancisë në Sigurimin e Jetës dhe rregullat e funksionimit të saj. Struktura u krijua në mënyrë që të mbrojë të drejtat e të siguruarit në rastin e falimentimit në sigurimin e Jetës. Sipas ligjit, Këshilli Mbikëqyrës i strukturës së re do të përbëhet nga pesë anëtarë, përkatësisht dy përfaqësues të qeverisë, një nga Komisionit Kombëtar për Fondin e Tregjeve Financiare dhe dy anëtarëve të zgjedhur në mbledhjen e kompanive të sigurimit të Jetës. Gjithashtu, projekti përfshin pjesëmarrjen e detyrueshme të kompanive të sigurimit të Jetës në Fondin për Garancinë. Garancia maksimale do të jetë rreth 20,000 UAH (monedha lokale) ose 1,900 Euro. Sipas autoriteteve, krijimi dhe rregullimi i këtyre strukturave, për të mbrojtur të siguruarit në rast të falimentimit të një kompanie të sigurimit të Jetës do të ndihmojë për të rifituar besimin e publikut dhe për të krijuar kushte të favorshme për zhvillimin e qëndrueshëm të tregut të sigurimeve ukrainas.

Kroaci

Agjencia e Kërkimit të Tregut, "Promocija Plus" deklaroi që shitjet e makinave të reja të pasagjerëve në Kroaci ranë 23% ose me 30,029 automjete në njëmbëdhjetë muajt e parë të vitit.

Estoni

Në një deklaratë për median, dega e SEB, grup bankar në Estoni theksoi se të gjitha kompanitë e sigurimeve në Estoni do të duhet ti përmbahen parimit unisex kur hartojnë kontratat e sigurimit duke filluar nga 21 dhjetor 2012. Kjo do të thotë se normat e sigurimit të Jetës për gratë do të jenë të barabarta ata me burrat. Pra për gratë dhe burrat e së njëjtës moshë, primet e sigurimit do të jenë të barabartë për të njëjtën shumë siguri.

Për shembull, një kontratë bazë e sigurimit të riskut e lidhur për 15 vjet për një shumë të siguar për 50,000 Euro, e cila i kushton tani një gruajë në moshën 30 vjeç rreth 8.50 Euro në muaj, sipas listës aktuale së çmimeve SEB. Ndërsa pas ndryshimit ajo do të jetë në rreth 16.50 Euro sipas listës së re të çmimeve unisex. Nisur nga parametra të njëjta, për burrat primi është 18 Euro në këtë moment, por do të jetë 16.50 Euro me kursin e ri.

Statistikat e SEB tregojnë se ka një numër në rritje të klientëve që mendojnë shumë përpara, kur është fjala për risqet dhe detyrimet financiare afatgjata në jetë. Krahasuar me vitin 2010, numri i kontratave të Sigurimit të Jetës të përfunduara është rritur 1.5 herë.

Në një deklaratë për median, dega e SEB, grup bankar në Estoni theksoi se të gjitha kompanitë e sigurimeve në Estoni do të duhet t'i përmbahen parimit unisex kur përfundojnë kontratat e sigurimit duke filluar nga 21 dhjetor 2012.

Për këtë numër punuan:

R. Guri, D. Kalaja, R. Eltari, E. Beqir-Aga, Dh. Hazbiu, E. Kokona